

Is se Apetit Vlore
thit Gjyqesor Vlore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORE
Rregj. Them 429
e ardhjes 12.10.2010

Nr.429 Vendimi
Data 01.11.2010

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORE, E PERBERE PREJ :

HERILA ÇELA – GJYQTARE

Asistuar prej sekretares gjyqesore Eglantina Taushani, sot me date 01.11.2010, perfundoi ne séance gjyqesore me dyer te hapura, çeshtjen penale Nr.428 date 12.10.2010, qe i perket

KERKUES :

[redacted] i biri [redacted] datelindja 22.12.1975,
lindur dhe banues ne Tirane, adresa:rrg. [redacted]
[redacted] perfaqesuar ne gjykim nga [redacted]
[redacted] me prokure te posacme me nr.5432 rep. Nr.792 kol. e
dates 11.10.2010.

PALE E INTERESUAR: Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore, perfaqesuar nga
Prokuror [redacted]

OBJEKTI :

Kundershtim i vendimit date 06.10.2010, i prokurorit [redacted]
[redacted] prane Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Vlore « Per
sekuestrumin e sendeve te ndodhura ne ambjentet e Shoqerise
[redacted]

BAZA LIGJORE :

Neni 287/2 i Kodit penal dhe nenet 212 dhe 218 te Kodit te
Procedures Penale.

Gjykata, ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te zhvilluar ne prani te
paleyve:

Pasi degjoi perfaqesuesin e kerkuesit [redacted] te tij [redacted] i cili kerkoi pranimin e kerkeses sipas objektit te saj, si te mbeshtetur ne ligj dhe prova,

Pasi degjoi palen e interesuar ne kete gjykim, organin e akuzes prokurorine e Rrethit Gjyqesor Vlore te perfaqesuar prej Prokurorit te [redacted] i cili kerkoi :

Rrezimin e kesaj kerkese si te pabazuar ne ligj dhe ne prova,
dhe pasi çmoi dhe vleresoi provat e marra ne seance gjyqesore;

VEREN

Kerkuesi [redacted] me kerkesen e paraqitur perpara Gjykates me objekt gjykimi i kerkuar prej saj Kundërshtim i vendimit date 06.10.2010, i prokurorit [redacted] dhe Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Vlore «Per sekuestrimin e sendeve te ndodhura ne objektet e Shoqerise [redacted]

Gjate shqyrtimi gjyqesor te kesaj ceshtje, pas administrimit te te gjitha provave te paraqitura ne kete gjykim, rezultuan te vertetuara;

I. Rrethanat e Faktit

Ne daten 01.10.2010 Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore ka regjistruar procedimin penal Nr.1516, per kryerjen e vepres penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale" te parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, ne ngarkim te shtetasit Italian [redacted]. Me date 05.10.2010 eshte bere rregjistrimi i emrit te personit qe i atribuohet vepres penale dhe konkretisht per shtetasit [redacted] i dhe [redacted] per kryerjen e vepres penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale", parashikuar kjo nga neni 287/2 te Kodit Penal.

Persona nen hetim jane shtetasi italian [redacted] dhe subjekte te tjere te perfshire ne Shoqerine Aksionere [redacted]

Ky subjekt figuron i regjistruar ne regjistrat e Qendres Kombetare te Regjistrimit me qender ne kete adrese: [redacted] e cila mban numer identifikimi [redacted] (prove kjo e cila eshte administruar ne dosjen gjyqesore me cilesine e proves shkresofe).

Nga te dhenat e grumbulluara nga organi procedues rezulton se me date 02.02.2010 eshte themeluar Shoqeria Aksionere [redacted] me seli ne Tirane. Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte kryesisht ne sherbime nepermjet internetit per parashikimin e zhvillimit te lojrave te fatit, te kazonova, basteve, garave te ndryshme te te gjitha llojeve. Kjo shoqeri rezulton te jete themeluar nga shtetasit [redacted] (djali i personit nen hetim), dhe kerkuesit (ne kete process gjyqesor [redacted])

Prudentino ne kohen e themelimit te kesaj shoqerie ka patur 80% te aksioneve te kesaj shoqerie, ndersa shtetasi [redacted] ka patur 20% te aksioneve. Ne daten 30.09.2010 Asambleja e Aksionereve te kesaj shoqerie ka vendosur shitjen e pjeses se kapitalit themeltar te shtetasi [redacted] shtetasi [redacted].

Por ne ambientet e ketij subjektit tregtar dyshohet se gjenden sende te cilat sherbejne per ushtrimin e aktivitetit dhe qe kane lidhje me vepren penale per te cilen procedohet.

Nga te dhenat e grumbulluara nga organi procedues rezulton qe ne ambientet e subjektit tregtar gjenden sende te cilat sherbejne per ushtrimin e aktivitetit dhe qe kane lidhje me vepren penale per te cilen procedohet.

Ne daten 06.10.2010 prokurori i kesaj ceshtje prane Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Vlore ka vendosur:

"Te sekuestroje ne amjentet e Shoqerise [redacted] llogarite bankare ne emer te Shoqerise [redacted] adrese [redacted] ne cdo filial apo zyre te kesaj shoqerie, sendet qe ndodhen ne keto ambiente."

Ne daten 12.10.2010 kerkuesi [redacted] ka paraqitur kerkesen objekt gjykimi, prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore.

II. Pretendimet e Paleve

Kerkuesi ka pretenduar se vendimi i sekuestrimit eshte i padrejte per shkak te keqinterpretimit te rrethanave te faktit duke kerkuar ne kete menyre kundersiztimin e vendimit date 06.10.2010, te prokurorit [redacted] prane Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Vlore «Per sekuestrimin e sendeve te ndodhura ne ambientet e Shoqerise [redacted]»

Shoqeria [redacted] sh.a. dhe kerkuesi [redacted] nuk ushtrojne aktivitet ekonomik, pasi akoma nuk eshte mare leja per ushtrimin e aktivitetit nga autoritetet shteterore.

Shoqeria [redacted] sh.a. synonte te ushtronte aktivitetin e saj nepermjet perdorimit te mjeteve ekonomike me prejardhje te ligjshme. Midis kerkuesit [redacted] dhe personit nen hetim [redacted] nuk ka asnje marredhenie juridike apo faktik [redacted] nuk rezulton te jete ortak themelues i shoqerise [redacted] Sh.A.

Organi procedues, nepermjet perfaqesuesit te tij ka parashtruar se ne ambientet e subjektit tregtar gjenden sende te cilat sherbejne per ushtrimin e aktivitetit dhe qe kane lidhje me vepren penale per te cilen procedohet dhe konkretisht ate te "Pastrimit te produkteve te vepres penale" te parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Nga ana e organit te akuzes eshte vleresuar se gjenden kushtet e parashikuara ne
penin 208 i Kodit te Procedures Penale, dispozite ligjore kjo e cila shprehimisht
parashikon:

*"Gjyqtari ose prokurori disponojne me vendim te arsyetuar
sekuestrimit e provave materiale dhe te sendeve qe lidhen me veprën
penale kur ato jane te domosdoshme per vertetimin e fakteve.*

*Sekuestrimit e kryen vetë ai qe ka nxjerrë vendim ose oficerët e
policisë gjyqësore të deleguar me të njëjtin vendim.*

*Kopja e vendimit të sekuestrimit i dorëzohet të interesuarit, në qoftë se
është i pranishëm."*

III. Në lidhje me provat

Per vertetimin e pretendimeve te tij kerkuesi ka paraqitur ne cilesine e provave
shkresore provat si me poshte:

1. Formular urdhër pagese muaji mars 2010 , me nr. Serie L01501014D2W0012
2. Formular urdhër pagese muaji prill 2010 , me nr. Serie L01501014D2WV015
3. Formular urdhër pagese muaji mars 2010 , me nr. Serie 01501014D2W0012
4. Formular urdhër pagese muaji maj 2010 , me nr. Serie L01501014D2XP01Z
5. Formular urdhër pagese muaji qershor 2010 , me nr. Serie L01501014D2YJ1W
6. Formular urdhër pagese muaji korrik 2010 , me nr. Serie L01501014DZFO1B
7. Formular urdhër pagese muaji korrik 2010 , me nr. Serie L01501014D2ZFO29
8. Mandat pagese date 20.07.2010
9. Formular urdhër pagese muaji gusht 2010 , me nr. Serie L01501014D30801J
10. Formular urdhër pagese muaji gusht 2010 , me nr. Serie L01501014D30802H
11. Mandat pagese date 20.09.2010
12. Urdhër pagese muaji gusht 2010 me nr. Serie L01501014D2ZF045
13. Urdhër pagese muaji shtator 2010 nr. Serie L01501014D30804D
14. Vërtetim i kryerjes se regjistrimeve te tjera date 01.10.2010
15. Vendim nr. 1 date 30.09.2010 për shitjen e 80% te aksioneve nga aksionari kryesore Anxhelo Prudentino me aksion 80% te kapitalit.
16. Procesverbal date 30.09.2010
17. Kontrate shitblerje te 80 aksioneve ose 80% te kapitalit themeltar te aksionarit [redacted] te shoqërisë [redacted] sh.a [redacted]
18. Vendim i asamblesë se aksionareve te [redacted] date 03.03.2010
19. Vendim nr. 2 date 01.10.2010 i aksionareve te [redacted]
20. Kontratë hua parash date 05.03.2010 pala huadhenesë [redacted] dhe pala huamarese [redacted]
21. Kontratë hua parash date 05.03.2010 pala huadhene [redacted], dhe pala huamares [redacted]
22. Formular urdhër pagese muaji gusht 2010 , me nr. Serie L01501014D30802H
23. Mandat arkëtimi date 20.09.2010

24. Formular urdhër pagese muaji korrik 2010 , me nr. Serie L01501014D2ZF029
25. Formular urdhër pagese muaji qershor 2010 , me nr. Serie L01501014D2YJ03S
26. Mandat arkëtimi date 20.07.2010
27. Letër autorizimi drejtuar bankës CREDINS date 06.10.2010, bashkangjitur urdhër xhirimi date 06.10.2010
28. Çertifikate regjistrimi date 01.03.2010, bashkangjitur ekstrakt i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit "shoqëria anonime"
29. Akt themelimi i shoqërisë aksionare [redacted] date 14.04.2008.
30. Statut i shoqërisë aksionare [redacted] date 14.04.2008.
31. Vendim për kryerjen e veprimeve hetimore date 06.10.2010
32. Vendim për sekuestrimin e sendeve date 06.10.2010
33. Procesverbal sekuestrimi date 06.10.2010

IV. Argumentimi ligjor

Veprimtaria procedurale e ndermare nga prokurori, me qëllim sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale gjendet e bazuar në fakt dhe në ligj. Në keto kushte kjo rrethancë passjell rrezimin e kërkeses të paraqitur prej kerkuesit

Baza ligjore e përdorur nga organi i akuzës për urdherimin e sekuestrimit janë dispozitat ligjore dhe konkretisht **nenet 208 pika 1 i Kodit të Procedurës Penale dhe 287, pika 2 të Kodit Penal.**

1. Keto dispozita shprehimisht citojnë:

"Gjyqtari ose prokurori disponojnë me vendim të arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve..."

Neni 287/2 të Kodit Penal

"1. Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i ujen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale.

2. Ndalohet publikimi i regjistrimeve të bëra deri në marrjen si të pandehur të personit që i atribuohet vepra penale."

Faktet e pretenduara të cilat kanë lejuar dhe mundësuar marrjen e masës përbejne ushtrim të aktivitetit të kunderligjshëm në formën e vepres penale.

Sendet e sekuestruara kanë vlerën e burimit të provës ose të provës materiale për vërtetimin e një veprimtarie të kunderligjshme. Sekuestrimi i sendeve që lidhen me

penale nuk kushtezohet nga fajesia penale e subjekteve te caktuara, gjithashtu nuk kushtezohet me titullin e pronesisë apo te posedimit mbi keto sende.

Pavaresisht, vertetesise se pretendimeve te kerkuesit ne lidhje me gjendjen e faktit, rrezimin e sendit apo perkatesine e pronesisë, sekuestrimi i sendeve ka qene i domosdoshem per tu perdorur ato, pra sendet ne cilesine e provave qe mund te sherbejne per vertetimin e nje veprimtarie te kunderligjshme.

Sekuestrimi eshte i lejueshem dhe i mundur kur vertetohet lidhja midis sendeve dhe veprës penale.

Pretendimet e tjera te kerkuesit ne lidhje me pergjegjesine penale, në pjesemarrjen apo jo ne aktivite te kunderligjshme te cilat perbejne apo jo veper penale, nuk jane objekt i ketij gjykimi.

Ne kushtet kur sekuestrimi i sendeve nuk ka qene i lidhur dhe rrjedhoje e pjesemarrjes apo jo ne veprat penale te kerkuesit, pretendimet e kerkuesit te parashtruara ne kerkese ne lidhje me keto shkaqe gjenden te pabazuara.

Rrethanat e faktit te pretenduara ne vendimin e sekuestros, natyra e sendeve te sekuestruara vertetojne ne menyre te padyshimte lidhjen e sendeve te sekuestruara me veprën penale.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar ne nenin 112 te Kodit te Procedres Penale;

VENDOSI

- Rrezimin e kerkeses se kerkuesit [redacted] ne pale te interesuar Prokuriria e Rrethit Gjyqesor Vlore me objekt « Kundershtim i vendimit date 06.10.2010, i prokurorit [redacted] prane Prokurorisë se Rrethit Gjyqesor Vlore « Per sekuestrimin e sendeve te ndodhura ne ambientet e Shoqeris [redacted]

- Kunder ketij vendimi lejohet ankim brenda afateve ligjore ne Gjykatën e Apelit Vlore.

U shpall ne Vlore me date 01.11.2010

SEKRETARE
EGLANTINA TAUSHANI



GJYQTARE
HERILA ÇELA



Vendimi mori forme te prere me vendimin nr 205 date 07.12.2010 te Gjykates se Apelit Vlore e cila ka vendosur:

Mospranim ankimi

KANCELARE
IRMA DHIMITRIADHI

Me vendimi e Gjykates se Larte Kolegji penal nr 50 date 09.03.2011 eshte vendosur :

Prishjen e vendimit nr 205 date 07.12.2010 te Gjykates se Apelit Vlore dhe dergimin e ceshtjes per rigjykim ne ate Gjykate , me tjetet trup gjykues.

KANCELARE
IRMA DHIMITRIADHI

Vendimi mori forme te prere me vendimin nr 76 date 20.04.2011 te Gjykates se Apelit Vlore e cila ka vendosur :

Lenien ne fuqi te vendimit nr 429 date 01.11.2010, te Gjykates se rrethit Gjyqesor Vlore.

KANCELARE
IRMA DHIMITRIADHI